

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Universiteti	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj
Njësia akademike	Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës
Programi	Inxhinieria Industriale me Informatike
Titulli i lëndës	Gjuhë angleze II
Niveli	Bachelor
Statusi lëndës	Obligative
Viti i studimeve	II, Semestri III
Numri i orëve në javë	2
Vlera në kredi – ECTS	3
Koha / lokacioni	
Mësimdhënësi i lëndës	
Detajet kontaktuese	
Përshkrimi i lëndës	<i>Lënda “Gjuhë angleze II” fokusohet në përforcimin e mëtutjeshëm të katër shkathtësive kryesore gjuhësore: të shkruarit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të folurit. Studentët do të kenë mundësi që t’i mësojnë dhe shqyrtojnë proceset dhe strategjitë e ndryshme të përvetësimit të këtyre katër shkathtësive. Literatura kryesore që do të përdoret gjatë ligjëratave është “Global Intermediate”, e cila do ua lehtësojë studentëve përdorimin e gjuhës angleze në klasë dhe jashtë saj. Përpos kësaj, në këtë lëndë do të shqyrtohen edhe tema të cilat janë më specifike për fushën e studimit për t’u dhënë rast studentëve të familiarizohen me disa terme të përgjithshme që do t’ju duhen në profesionin e tyre. Kapituj të zgjedhur nga “English for IT Level 2” dhe “Oxford English for Information Technology” do të përdoren si literaturë shtesë për këtë qëllim.</i>
Qëllimet e lëndës	<i>Qëllimi kryesor i kësaj lënde është zhvillimi i mëtutjeshëm i shkathtësive gjuhësore të cilat do të ushtrohen dhe përforcohen përmes punës në klasë dhe detyrave të shtëpisë.</i>
Rezultatet e pritura të mësimnxënies	Pas përfundimit të modulit studenti do të jetë i aftë që: • Të marrë pjesë në biseda shoqërore, të flasë për veten dhe të shprehë qartë mendimet e veta rreth çështjeve të ndryshme; • Të kuptojë qëllimin, idetë kryesore dhe disa detaje të teksteve të përbëra prej dy ose tri paragrafesh; • Të shkruaj thjeshtë, por në mënyrë efektive për një mendim, ndjenjë apo përvojë jetësore; • Të dëgjojë dhe kuptojë biseda me tema që janë të njohura për të.

Parakushtet		Kalimi i provimit gjuhe angleze I	
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Ora	Dita/Java	Totali
Mësim teorik dhe praktik	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në terren			
Kollokviume, seminare dhe projektet	1	1	1
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	2	1	2
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz dhe provim final)	1	2	2
Projektet dhe prezantimet			
Totali			75
Metodologjia e mësimdhënies			
Kursi zgjat 15 javë dhe zhvillohet përmes ligjëratave dhe ushtrimeve individuale dhe grupore. Angazhimi i studentëve në mësim është element kyç në arritjen e rezultateve të nxënies andaj studentët inkurajohen që të marrin pjesë rregullisht dhe aktivisht në ligjërata dhe në aktivitetet e ndryshme që zhvillohen gjatë tyre. Ligjërata, ushtrime përmes pyetjeve e përgjigjeve, diskutime në grup dhe punë në çifte.			
Metodat e vlerësimit			
Vlerësimi i studentit bëhet si më poshtë: - Aktiviteti në mësim dhe detyrat e shtëpisë: 10% - Testi gjysmësemestral: 30% - Testi përfundimtar, Provimi: 60% Në këtë formë vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme, pra gjatë tërë semestrit, përmes aktiviteteve të ndryshme në klasë, por edhe në fund përmes provimit. Aktiviteti në mësim përfshin angazhimin dhe pjesëmarrjen aktive të studentit në diskutime me tema të ndryshme që zhvillohen gjatë ligjëratave. Detyrat e shtëpisë caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjëratës vijuese. Për secilën detyrë të përfunduar të shtëpisë studenti fiton pikë të cilat në fund			

	<i>llogariten me pikët e tjera të grumbulluara përmes formave të tjera të vlerësimit.</i> <i>Në testin gjysmësemestral dhe provimin përfundimtar studenti vlerësohet përmes një formulari që plotësohet individualisht nga secili student. Formulari mund të përmbajë pyetje objektive apo subjektive përmes së cilave maten rezultatet e të nxënit të studentit. Pyetjet objektive janë të llojit: 1) me zgjedhje të shumëfishta; 2) plotësim, dhe 3) përputhje. Ndërsa pyetjet subjektive janë të llojit të një eseje përmes së cilit vlerësohen shkathtësitë e të shprehurit dhe artikulimit të mendimeve të studentit në gjuhën angleze.</i> <i>Vlerësimi:</i> <i>90-100 pikë – vlerësohet me notë 10(dhjetë)</i> <i>80-89 pikë – vlerësohet me notë 9(nëntë)</i> <i>70-79 pikë – vlerësohet me notë 8(tetë)</i> <i>60-69 pikë – vlerësohet me notë 7(shtatë)</i> <i>50-59 pikë – vlerësohet me notë 6(gjashtë)</i> <i>0-49 pikë – studenti përsërit provimin.</i>
Raporti i teorisë dhe praktikës	<i>70% praktikë dhe 30% punë laboratorike.</i>
Literatura	
Literatura bazë	<i>1. Global Intermediate: Student's Book by Lindsay Clandfield, Rebecca Robb Benne, with additional material by Amanda Jeffries. Macmillan Education, 2011.</i>
Literatura shtesë	<i>2. Q: Skills for Success, Listening and Speaking (Level 3) by Miles Craven, Kirstin D. Sherman. Oxford University Press, 2013.</i> <i>3. English for IT Level 2 by David Hill. Pearson Longman Limited, 2012.</i>

	4. Oxford English for Information Technology by Eric H. Glendinning, John McEwan. Second Edition. Oxford University Press, 2011.
Plani i dizajnuar i mësimit	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	<i>Introduction to the course, discussion of the syllabus and the necessary materials</i>
Java e dytë	<i>Hot & Cold Future forms: plans & intentions; Endless energy? A desert survival expert; Energy sources; Materials</i>
Java e tretë	<i>Hot & Cold (cont.) 'so' & 'such'; Real conditionals; Coming in from the cold; Weather ups and downs; In a department store; cold (metaphor); Words that describe statistics</i>
Java e katërt	<i>Friends & Strangers Present perfect and past simple; 'yet' and 'already'; A creative friendship; Adjective suffixes: -ive, -ful, -ous; Expressions with 'what'</i>
Java e pestë	<i>Friends & Strangers (cont.) Modals of deduction; Strangers on a Train; Average UK Man; 'usual' and 'unusual'; Making predictions about a film</i>
Java e gjashtë	<i>Law & Order Modals of obligation and permission; Asi</i>
Java e shtatë	<i>Law & Order (Cont.) Present perfect simple and continuous; Separable phrasal verbs; 'I'm a Teacher, Get Me Out of Here!'; An orderly lunch; Phrasal verbs with 'up'</i>
Java e tetë	<i>Testi gjysmësemestral</i>
Java e nëntë	<i>Seen & Heard Passive voice; Now you see it... now you don't; Optical illusions; Colors and shapes</i>
Java e dhjetë	<i>Seen & Heard (Cont.) Reported statements and questions; Overheard in New York; Ways of speaking; An interview about the Stasi; Electronic equipment</i>
Java e njëmbëdhjetë	<i>Supply & Demand Defining relative clauses; A good swap/ Trash or treasure; Inexact numbers; Wordbuilding: trade</i>
Java e dymbëdhjetë	<i>Supply & Demand (Cont.) Countable & uncountable nouns; Meeting our demands; Three men on a desert island; Abstract nouns; Something you were motivated to do</i>
Java e trembëdhjetë	<i>From English for Information Technology: IT jobs and duties Discussing IT-related jobs and duties; Expressing frequency: adverbs of frequency and time expressions; IT jobs and duties</i>
Java e katërmëdhjetë	<i>From English for Information Technology: System specifications Giving hardware specifications; Large and small numbers; Hardware</i>
Java e pesëmbëdhjetë	<i>Review of the covered material, preparation for the final exam</i>
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
<i>Studentët janë të obliguar të përcjellin me rregull ligjëratat dhe ushtrimet dhe të kenë me vete materialin e nevojshëm me qëllim të realizimit sa më të mirë të ligjëratave dhe përfshirjes së tyre në procesin mësimor. Studentët duhet të vijnë me kohë në ligjërata, të mbajnë qetësinë dhe të marrin pjesë në diskutimet e aktivitetet e ndryshme që zhvillohen në klasë.</i>	

